



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRIA E DREJTËSISË
Nr. 6987
Datë, më 18.12.2023

6871

V E N D I M

Nr. 736, datë 13.12.2023

P Ë R

MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR SHTETIN E SË DREJTËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, si dokument i politikave shtetërore, piketa hapëse të grupkapitullit të parë "Themeloret", në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme marrin masat për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të këtij udhërrëfyesi.
3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe të gjitha institucionet që kanë në përgjegjësi masat e përfshira në udhërrëfyes për zbatimin e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

MINISTRI I DREJTËSISË

ULSI MANJA

MINISTRI I BRENDSHËM

TAULANT BALLA